



Makerspace
Innovation Center
Prizren

ITP Innovation &
Training Park
Prizren

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

(BASHKËFINANCIMI)



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

ndërmjet:

Makerspace Innovation Center Prizren	
Pranuar me dt. 26/03/2024	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
Administrata	043/2024

01 Nr. 221/24 Dt. 26.03.2024

Komuna e Prizrenit,

OJQ “Makerspace - Innovation Center Prizren” (MICP)

dhe

Innovation and Training Park - Prizren (ITP)

Për projektin:

“Fuqizimi ekonomik i të rinjve përmes bashkëpunimit e mentorimit në
hapësirat e përbashkëta”

Neni 1

Qëllimi i memorandumit dhe përshkrimi i projektit

Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Prizrenit (më tej: Komuna) dhe Makerspace – Innovation Center Prizren (më tej: MICP) e ndërlidhur për bashkëpunim në agjendën digjitale të Prizrenit, zhvillimin ekonomik, ngritjen e bizneseve të reja startup, implementimin dhe funksionalizimin e qendrës së Inovacionit, Ndërmarrësisë dhe Trajnimeve, Bazuar në marrëveshjen e menaxhimit të lidhur ndërmjet Makerspace – Innovation Center Prizren dhe Innovation and Training Park (më tej: ITP Prizren) për menaxhimin e hapësirave të përbashkëta të punës përbrenda Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren,

Bazuar në Neni 3, Pika 4 dhe Neni 14, Pika 1.4 të rregullores Komunale nr 001-011-201, dt: 03.01.2024, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve,

Bazuar në përvojën e deritanishme të MICP-së në përgatitjen dhe realizimin e projekteve me organizata kredibile vendore dhe ndërkombëtare;

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi në realizimin e projektit “Fuqizimi ekonomik i të rinjve përmes bashkëpunimit e mentorimit në hapësirat e përbashkëta” - Faza e parë përgjatë vitit 2024. Projekti synon të i ofrojë të rinjve të regjionit të Prizrenit mundësi bashkëpunimi, ndërveprimi dhe inkorporimi me ekosistemin e inovacionit nëpërmjet mentorimit në programet e edukimit jo-formal të MICP duke shfrytëzuar kapacitetet, resurset dhe hapësirat e përbashkëta që janë në menaxhimin e MICP.

Përgjatë zbatimit të projektit, përfitues do të jenë të paktën njëqind (100) të rinj të regjionit të Prizrenit në aktivitete si:

- Punëtori me tematika aktuale në fushën e teknologjisë dhe inovacionit,
- Takime rrjetëzuese dhe evente inspiruese me storie suksesi,
- Mentorim profesional në programet dhe trajnimet joformale,
- Hapësira të përbashkëta të punës dhe të ngjashme.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët (Komuna, MICP dhe ITP) pajtohen të bashkëpunojnë si në vijim:

- 2.1 – MICP merr përsipër të hartojë dhe implementojë programin/projektin “Fuqizimi ekonomik i të rinjve përmes bashkëpunimit e mentorimit në hapësirat e përbashkëta”.
- 2.2 – MICP merr përsipër zbatimin e aktiviteteve të projektit në tërësi,
- 2.3 – MICP merr përsipër njoftimin e palëve për kalendarin e aktiviteteve të projektit,
- 2.4 – MICP merr përsipër komunikimin dhe përfaqësimin e barabartë të palëve para publikut,
- 2.5 – Palët marrin përsipër bashkëpunimin ndërmjet vete,
- 2.6 – Palët marrin përsipër promovimin e aktiviteteve të projektit,
- 2.7 – Palët caktojnë personat përgjegjës për përcjelljen e aktiviteteve të projektit.

Neni 3

Obligimet e palëve (Financimi)

3.1 - Komuna e Prizrenit merr përsipër:

- 3.1.1 - Të bashkëpunojë me MICP për realizimin e aktiviteteve, detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara sipas planit të veprimit.
- 3.1.2 - Të sigurojë bashkëpunimin në mes të institucioneve komunale për lehtësimin e realizimit të projektit. MICP do të udhëheq/zhvillon procedurat financiare, si dhe organizon dhe mban aktivitetet e parapara të projektit.
- 3.1.3 -Të mbështesë projektin duke e bashkëfinancuar fazën e parë në vlerë prej *85,000.00 Euro (tetëdhjetë e pesë mijë euro)* sipas programeve:
 - Programi 1: Fuqizimi i të rinjve nëpërmjet aktiviteteve rrjetëzuese me shumën 38,000.00 Euro (tridhjetë e tetë mijë euro)
 - Programi 2: Mentorimi i përfituesve të aktiviteteve të edukimit në hapësirat e përbashkëta në vlerë: 47,000.00 Euro (katërdhjetë e shtatë mijë euro).
- 3.1.4 – Të caktojë një zyrtar përgjegjës për të mbikëqyrur projektin.

3.1.5 - Komuna e Prizrenit do të bëj transferimin e mjeteve të zotuara në lartësi prej 85,000.00 (€) Eur (tetëdhjetë e pesë mijë euro) në llogarinë bankare të MICP (zbatuesi i projektit).

Të dhënat e bankës:

Emri i xhirollogarisë: Makerspace – Innovation Center Prizren

Nr.xhirollogarisë: 1910000466031114, Banka: BKT Kosova

3.2 - Makerspace – Innovation Center Prizren merr përsipër:

3.2.1 – Të implementojë tërësisht programet/aktivitetet e projektit dhe ta zhvillojë më tej atë në shkëmbim të ngushtë me palët,

3.2.2 – Të udhëheq/zhvillojë procedurat financiare të projektit, duke respektuar standartet themelore të financimit, lidhur me kontraktimin, monitorimin publikimin dhe raportimin.

3.2.3 – Të raportojë me shkrim për implementimin e projektit në mënyrë narrative tek palët,

3.2.4 – Të hartojë raportin e detajuar financiar për shpenzimin e mjeteve të projektit, tek palët respektive.

3.2.5 – Të caktojë një zyrtar përgjegjës për të mbikëqyrur projektin sipas kontributit të MICP në projekt dhe të caktojë ekipin implementues të projektit.

3.2.6 - Të kontribuojë në projekt me angazhim në vlerë prej 35,000 Euro (tridhjetë e pesë mijë euro) në drejtim të realizimit të aktiviteteve të projektit.

3.3 – ITP Prizren merr përsipër:

3.2.1 – Të bashkëpunojë me MICP për realizimin e aktiviteteve të projektit sipas marrëveshjes paraprahe për menaxhimin e hapësirave të përbashkëta,

3.2.2 – Të promovojë aktivitetet e projektit,

3.2.3 – Të ndihmojë MICP duke e këshilluar për realizim të projektit sipas praktikave të mira,

3.2.4 – Të caktojë sipas mundësisë një person përgjegjës për përcjelljen e aktiviteteve të projektit,

3.2.6 – Mbështetja e ITP Prizren për këtë projekt është e rregulluar nëpërmjet një marrëveshje të ndarë mes ITP Prizren dhe MICP e cila përshinë investime infrastrukturore në hapësirat e përbashkëta të punës, mbështetjes në kosto operative të hapësirave dhe promovimit, në vlerë mbi 50,000.00 Euro (pesëdhjetë mijë euro).

Neni 4

Kohëzgjatja e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit

4.1 – Për të përmbushur qëllimin e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, i njeiti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit deri në fund të vitit kalendarik 2024, me mundësi vazhdimi edhe për vitet në vijim.

Neni 5

Pëlqimi i palëve

5.1 – Për përmbushjen e qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, palët do të veprojnë me besueshmëri të plotë.

5.2 – Të gjitha paqartësitë apo mospajtimet në mes të paleve të kësaj marrëveshjeje do të diskutohen përmes bisedimeve.

5.3 - Nëse palët kanë ndonjë mosmarrëveshje, atëherë ato i drejtohen marrëveshjeve bazë ndërmjet tyre dhe rregulloreve në fuqi.

Neni 6

Nënshkrimi

6.1 – Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet më datë 26 / 03 / 2024 në Prizren.

6.2 – Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në gjashtë (6) kopje, nga dy (2) për secilën palë.

Komuna e Prizrenit


Shaqir Totaj
Kryetar i Komunës




Makerspace Innovation Center


Enis Qafëleshi
Drejtor Ekzekutiv



ITP Prizren


Muhamed Rexhepi
Përfaqësues i autorizuar

